

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Kina vijon mbështetjen për Iranin, Wall Street Journal: 1,300 dërgesa me komponentë me përdorim të dy fishtë
ADRESA	https://top-channel.tv/2026/09/24/kina-vijon-mbeshtetjen-per-iranin-wall-street-journal-1300-dergesa-me-komponente-me-perdorim-te-dyfishte/
BURIMI	top-channel.tv
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	24 shtator 2026, 07:48:13 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
LEXUAR NGA FAQJA	24 shtator 2026, 07:45:00 UTC <i>Portali nuk e deklaroi datën në asnjë formë makinë-lexueshme; kjo është ora e shkruar për njeriun, e lexuar nga faqja me meto dën text_date. Dritarja: 24 shtator 2026, 07:44:00 UTC → 24 shtator 2026, 07:46:00 UTC. Kalon nga një rregull i yni që mund t ë gabojë, prandaj shfaqet si e lexuar dhe jo si e deklaruar.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	c672e6038b3cbc9d802ede2e7f885cb5edb2cca674e7bfdb8b8ac81fa11c6c42
TEKSTI	a099a450531456e89ee64537107c7ee2bce1f6c36e2c0119a0ccb893d94d36c7
PAMJA	3ea3717b5bd5fd9de6dc72b70f811e79344d20ff43049b2458dd58bb89436409

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	e788ee8c9ddce210c4563c2befa08a9d109906dfb1ea59e8fafa75c074a9400f
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	1057a6098f5231b1a7fb769cdeef6f94e5e01b8f35ccfb6287a805b5f635f739
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/e788ee8c9ddce210c4563c2befa08a9d109906dfb1ea59e8fafa75c074a9400f>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

BOTA KRYESORE TË FUNDIT

Kina vijon mbështetjen për Iranin, Wall Street Journal: 1,300 dërgesa me komponentë me përdorim të dyfishtë

24/09/2026 09:45



Kina ka vijuar furnizimet me komponentë me përdorim të dyfishtë drejt Iranit, pavarësisht luftës me SHBA-në dhe Izraelin dhe paralajmërimeve të Uashingtonit për sanksione të reja.

Sipas një raporti të Wall Street Journal, gjatë gjysmës së parë të vitit 2026, rreth 1,300 dërgesa nga furnizues kinezë iu drejtuan Ministrisë së Mbrojtjes së Iranit, duke kontribuar në mirëmbajtjen e programeve të saj të armëve, pavarësisht dëmeve të shkaktuara nga sulmet.

Të dhënat e siguruar nga ImportGenius, të cilat mbulojnë periudhën nga janari 2025 deri në qershor 2026, përfshijnë mijëra dërgesa për kompanitë iraniane dhe Ministrinë e Mbrojtjes. Mes produkteve të dërguara janë pajisje GPS, motorë dhe pjesë motorësh avionësh, si dhe komponentë të tjerë që mund të përdoren në sistemet ushtarake.

Një nga dërgesat mbërriti më 17 qershor, në të njëjtën periudhë kur Uashingtoni dhe Teherani ranë dakord për një armëpushim 60-ditor, ndërsa Pekini promovonte rolin e tij si ndërmjetës për paqen. Vetëm dy ditë më vonë, sipas të dhënave të analizuar nga WSJ, pasuan më shumë se një duzinë dërgesash të tjera, me komponentë me vlerë mbi 6 milionë dollarë, të cilët mund të përdoren në prodhimin e dronëve.

Sipas gazetës amerikane, disa prej dërgesave përmendnin Nenin 119, i cili përjashton importet e mbrojtjes nga tarifit.

Pas fillimit të luftës më 28 shkurt, tregtia mes dy vendeve u godit ndjeshëm, ndërsa një bllokadë detare amerikane në prill kufizoi më tej furnizimet. Teherani reagoi duke forcuar lidhjet ajrore me Kinën.

Sipas të dhënave të FlightRadar24, kompania ajrore iraniane Mahan Air, e cila është nën sanksione amerikane, rriti fluturimet nga Pekini, Shanghai dhe Guangzhou drejt Teheranit nga katër në javë në fillim të marsit në rreth 27 deri në fund të prillit.

Në javën e parë të shtatorit, kompania operoi 39 fluturime në linjat Kinë-Iran, rreth dyfishin e niveleve para luftës. Disa prej këtyre fluturimeve nuk ishin të disponueshme për rezervime nga pasagjerët.

Studiuesja Kate Koren nga Qendra për Studime Strategjike dhe Ndërkombëtare (CSIS) identifikoi kompani kineze që reklamoni komponentë elektronikë të ndjeshëm, të përdorur në dronët e tipit Shahed. Sipas saj, furnizuesit po kontaktonin klientë iraniane përmes panairove tregtare dhe reklamave në gjuhën persiane.

Kryesore



Kuvendi sot në seancë plenare/ Dy interpelanca urgjente dhe votimi për misionin në Gaza (Rendi i ditës)

07:43

"Tao kryetar Kuvendi, Skënderi më thirr me u taku"/ Mesazhet e Vlora Hysenit me Ergys Agasin zbulojnë klanin e Belinda Ballukut në PS dhe Polici

20:50

U plagos me thikë në Tiranë, ndërron jetë në spital 49-vjeçari

23:11

"Punon pa pushim, nga mëngjesi në darkë"/ Jeta si bashkëshortja e Presidentit të SHBA-së, rrëfhet Melania Trump

17:11

Debutimi kundër Holandës së Xavit, Klopp: Nuk kisha kohë të bëhesha nervoz

22:17

Më të lexuarat

"Urgjenca e SPAK-ut për ta bërë publik arrestimin fsheh një hall të madh"/ Analiza e Filip Çakulit: Vlora Hyseni dhe misteri i certifikatës së sigurisë

"Tao kryetar Kuvendi, Skënderi më thirr me u taku"/ Mesazhet e Vlora Hysenit me Ergys Agasin zbulojnë klanin e Belinda Ballukut në PS dhe Polici

"Belinda Balluku është takuar me Altin Dumanin"/ Gazetari në Top Story: Shumë shpejt do i sekuestrohet edhe vila e tretë

"SPAK u nxitua me arrestin", eksperti i sigurisë, Xhavit Shala: Prokuroria e Posaçme duhej të vepronte ndryshe me kreun e SHISH, ndoshta me dorëheqje

"E ke dëgjuar atë këngën Zegjine, Zegjine..."/ Aktivistja i zë pritë deputetes së PS në zyrat e Kuvendit. Çausi: Sa të paguajnë?

U plagos me thikë në Tiranë, ndërron jetë në spital 49-vjeçari

"Hyseni tregoi që Agasi ishte bashkëpunëtor i SHISH", gazetari Muhamed Velu në 'Top Story': Nuk do merret vesh ndonjëherë, SPAK nuk mundet...

"Kisha hajdutë në shtëpi, një ka vdekur"/ Vrasja e shqiptarit që hyri të vidhte një banesë në Itali, publikohet telefonata e pronarit me policinë

A është gjetur Bleona Mata pas 16 vitesh?



Përplasje LIVE mes nënës dhe avokatit në "Ftesë në 5": Do të të ndjek penalisht

Curri në Top Story: Mund të kenë pasur marrëdhënie, Kodi Penal nuk të dënon

Raporti i WSJ thotë gjithashtu se furnizimet kimike nga Kina kanë ndihmuar në rimbushjen e kapaciteteve të prodhimit të raketave iraniane, të dëmtuara nga sulmet izraelite në vitin 2024.

Pas raportimeve për eksporte të tilla në vitin 2025, forcat amerikane bastisën një anije që transportonte komponentë me përdorim të dyfishtë nga Kina drejt Iranit.

Në një letër të dhjetorit, kompania kineze e sanksionuar Haokun Energy deklaroi se kishte koordinuar licenca konfidenciale eksporti për perklorat natriumi, një material që përdoret në karburantin e raketave. Kompania kishte ngritur gjithashtu një subjekt në Pekin për transaksionin. WSJ konfirmoi listimin e kompanisë, por nuk mundi të përcaktonte nëse marrëveshja ishte përfunduar.

Uashingtoni ka shënjestruar gjithashtu rrjete që dyshohet se përpiqeshin të furnizonin Iranin me sisteme të reja portative kineze kundër tankeve dhe kundërajrore. Një prej përpjekjeve thuhet se përfshinte transportimin e tyre përmes Bjellorusisë, me synim fshehjen e marrësit përfundimtar.

Mbështetja mes dy vendeve nuk kufizohet vetëm te furnizimet ushtarake. Kina është shfaqur si blerësi më i madh i naftës iraniane që prej fushatës së "presionit maksimal" të nisur nga Donald Trump në vitin 2018.

Në vitin 2021, Pekini dhe Teherani nënshkruan një marrëveshje 25-vjeçare, ndërsa ligjvënës amerikanë vlerësojnë se Kina blen më shumë se 80% të eksporteve të naftës bruto iraniane.

Sipas zyrtarëve amerikanë dhe burimeve të cituara nga WSJ, pagesat janë lehtësuar përmes rrjeteve bankare dhe kompanive fiktive, përfshirë transaksione në juan.

Në një rast, shitjet e produkteve petrokimike iraniane në Egjipt do të kryheshin në juan përmes Sistemit Ndërkombëtar të Pagesave të Kinës (CIPS), pasi SHBA kundërshtoi përdorimin e dollarit.

Ndërkohë, Uashingtoni ka vendosur sanksione ndaj kompanive kineze të lidhura me furnizimet dhe imazhet satelitore. Zyrtarët amerikanë kanë lidhur gjithashtu imazhe satelitore kineze, të marra para dhe pas sulmit iranian të 17 korrikut, me një sulm ku u vranë tre ushtarë amerikanë në Jordani.

Pavarësisht sanksioneve, brenda administratës Trump ka pasur dallime mbi mënyrën se si duhet trajtuar Kina. Sekretari amerikan i Mbrojtjes, Pete Hegseth, ka pretenduar se Kina dhe Rusia i kanë mundësuar Iranit të vazhdojë operacionet, ndërsa Trump ka cituar garancitë e Xi Jinping se nuk kishte transferime armësh, duke deklaruar: "Unë u besoj atyre."

Sekretari amerikan i Shtetit, Marco Rubio, ka thënë se ndihma kineze nuk ka ndryshuar rrjedhën e luftës.

Pekini i ka hedhur poshtë akuzat për mbështetje të paligjshme ndaj Iranit, duke deklaruar se zbaton kontrollet e eksportit dhe kundërshton sanksionet e njëanshme.

Top Channel

I Bota »





Agjenti i OpenAI depërtoi në faqe qeveritare në Australi, kryeministri Albanese: Incidenti papranueshëm

24/09 08:57



SHBA dhe Kina zgjasin armëpushimin tregtar, marrëveshja në fuqi deri më 10 janar

24/09 08:36



Alarm për inteligjencën artificiale/ Altman dhe Amodi paralajmërojnë OKB-në: Duhet më shumë kontroll dhe bashkëpunim

24/09 08:25



Xi-Trump përballen me luftën tregtare, Europa mes tarifave amerikane dhe eksporteve kineze

24/09 08:20



Meloni ndryshon tonin ndaj Izraelit: Keni kaluar vijën e kuqe, Italia mbështet sanksionet

24/09 08:12



Sulme me raketa ruse në Kiev, të paktën dy të vrarë dhe gjashtë të plagosur

24/09 08:02

I Kryesore »



Protesta pranë Kuvendit, shoqërohen dy persona, tentuan të thyenin rrethimin e Policisë

24/09 09:45



"Shkova në shtëpi dhe mora thikën"/ Detaje nga vrasja e djeshme në Tiranë, dëshmia e autorit Toni Nake: Cara më bullizonte në mënyrë të vazhdueshme

24/09 09:43



Masa e sigurisë ndaj Vlora Hysenit dhe përgjimet e SPAK/ "Sa raste janë shpallur të pafajshme pas gjyqit publik? Beci: Asnjë nuk di. Demaliaj: Të mos bëjmë gjyq publik pa folur drejtësia

24/09 09:27




Kuvendi rrethohet me gardhe metalike, masa të forta sigurie para protestës

24/09 08:44



SHBA dhe Kina zgjasin armëpushimin tregtar, marrëveshja në fuqi deri më 10 janar

24/09 08:36



Xi-Trump përballen me luftën tregtare, Europa mes tarifave amerikane dhe eksporteve kineze

24/09 08:20

Na ndiqni:



I Video »



Top News – Sherr me thika në Tiranë. Ndërron jetë 49 vjeçari, arrestohet autori



Top Channel/ Dy operacione në 24 orë, arrestohen 2 persona me armë pa leje në Tiranë dhe Krujë



Top Channel/ Masa e sigurisë ndaj Embro Sulejmanit, avokati i tij mbërrin në GJKKO



Top Channel/ Arrestonet
Shpëtim Aliu, "Kumbari" i
drogës u kap në Rusi

Top Channel/ Berisha mbledh
kryesinë për çështjen e SHISH:
Nuk do bojkotojmë

Top Channel/ Zelensky: Putini
është pacienti zero, ndalni
paratë në Moskë

Lajme	Bota	Sport	Pop News	Programe	Top Channel
Lajmet e fundit	Opinion	Kombëtarja	Showbiz	Big Brother VIP	Rreth Top Channel
Politikë	Koment	Kategoria Superiore	Lifestyle	Për'puthen	Kontakt
Kronikë	Kosova dhe Rajoni	Kategoria e Parë	Fashion	Shqipëria LIVE	Bileta – Portokalli
Aktualitet	Shkencë dhe Teknologji	Premier League	Shëndeti	Fiks Fare	Puno në Top Channel
Ekonomi	Auto	La Liga	Dieta	Video	Privacy Policy & Terms of Use
Sociale		Serie A	Receta gatimi	Të gjitha programet	Aksesueshmëria
Video		Shumësportësh		Guida TV	
Top News LIVE		Sport Gossip			
© Top Channel 2001 - 2026 • Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i përmbajtjes së kësaj faqeje.					

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.